



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYESIA E KËSHILLIT BASHKIAK TEPELENË

VENDIM

Nr. 1 datë 23.01.2025

“Për miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 17, 56 dhe 57, dhe në mbështetje të Rregullores së Këshillit Bashkiak, miratuar me VKB nr. 15 datë 17.02.2020, Neni 27, Kryesia e Këshillit në mbledhjen e datës 23/01/ 2025;

Vendosi:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të mbahet më datë 30/01/2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes sipas dokumentit bashkëlidhur ketij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit për dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës, si dhe materialet relevante për mbledhjen tek secili këshilltar, tek kryetari i bashkisë, deputetët e qarkut dhe personat apo organizatat që kanë bërë kërkesë, si dhe me përgatitjen e dosjes së mbledhjes dhe dërgimin e dosjes së mbledhjes tek secili këshilltar dhe tek kryetari i bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Mjaftoni ZERAJ

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Vladimir BAKIAJ

Anëtari i Kryesisë së Këshillit

Dino SELIMI

Kryetar i Këshillit

Arben GUMENI





BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1 prot.

Tepelenë, më 23.01.2025

Procesverbal

I mbajtur sot me datë 23.01.2025 ora 10.00 në zyrën e këshillit bashkiak me Kryesinë e Këshillit për të diskutuar rendin e ditës dhe datën e mbledhjes

Marrin Pjesë:

1. Arben Gumeni
2. Vladimir Bakiaj
3. Mjaftoni Zeraj

Rendi i ditës së mbledhjes së këshillit në baze të p/vendimeve që cdo drejtori ka dërguar tek Sekretari i Keshillit.

Data e mbledhjes;

K/Këshillit Z. Arben Gumeni sygjeron që datë për mbledhjen e radhës të lihet datë 30.01.2025.

U miratua data e mbledhjes datë 30.01.2025.

1. Rendi i ditës si më poshtë: Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluara datë 24.12.2024.
3. **Projektvendim:** : “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Dhjetor 2024”.
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Dhjetor 2024”.
5. **Projektvendim:** : “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 % ose me fondet e buxhetit vendor”.
6. **Projektvendim:** “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë”

7. **Projektvendim:** “Për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë të cilat nuk mund ta perballojnë qiranë në tregun e lire”
8. **Projektvendim:** “Për miratimin e listës emërore të familjeve përfituese si dhe vlerës së bashkëfinancimit me qëllim përfitimin e fondeve nga programi i strehimit “Përmirsimi i banesave ekzistuese për vitin 2025”
9. **Projektvendim:** “Për dhënie titull nderi”
10. **Projektvendim:** “Për vendosjen e bustit”
11. **Projektvendim:** “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 89, datë 30.11.2023
“Për miratimin e kryesisë dhe kryetarëve të fshatrave në Bashkinë Tepelenë”
12. **Projektvendim:** “Për miratimin e planit operacional vjetor për vitin 2025 në fondin pyjor dhe kullosor të Bashkisë Tepelenë”
13. Çeshtje të tjera

Të pranishmit e miratuan këtë rend dite.

K/Këshillit falenderon të pranishmit.

Mbyllet mbledhja e Kryesisë

Sekretar i Keshillit

Valbona Çela

